



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:181961

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05638479

KPPP.nr.232/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Hamëz Zeqiraj” B.I., me NUI:810635188, me seli në Suharekë, Lagjja e Re nr.5, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avdullah Hoti, avokat nga Fushë Kosova, kundër debitorit “Pharma Tree” SH.P.K., me NUI:811409730, me seli në Prishtinë, rruga “Ali Vitia” Bll. C1, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.170/22 të datës 21.07.2022, të Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Pharma Tree” SH.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.170/22 të datës 21.07.2022, të Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.170/22 i datës 21.07.2022, i Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 78.00 € (shtatëdhjetë e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Hamëz Zeqiraj” B.I., ka lëshuar urdhër me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.DV-200664464248 të datës 26.06.2020 si dhe Faturës Nr.DV-200662204423 të datës

22.06.2020, me të cilin ka detyruar debitorin që kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumën prej 893.00 €, si dhe shpenzimet e përpilimit të propozimit për përmbarrim shumën prej 104.00 € së bashku me shpenzimet e procedurës përmbarrimore, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, ashtu që përmbarrimi të bëhet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit, si dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarrimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim në të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për përmbarrim, duke theksuar ndër të tjerash se faturat të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbarrimore nuk i janë dorëzuar debitorit së bashku me propozimin për përmbarrim, po ashtu faturat nuk i plotësojnë kushtet për tu konsideruar dokumente të besueshme, pasi që për tu konsideruar dokumente të besueshme të njëjtat duhet të jenë të nënshkruara dhe të vulosura, e që në rastin konkret të njëjtat nuk janë nënshkruar e as vulosur nga ana e debitorit. Tutje ka shtuar se me kreditorin kanë pasur marrëveshje që për mallrat të cilat nuk shiten të njëjtat do të kthen, andaj edhe shuma e kërkuar nuk është paguar për shkak se debitori nuk ka bërë porosi për ato mallra. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarrimor ta shfuqizoj.

Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, përmes përfaqësuesit të autorizuar duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara, për arsye se asnjë nga thëniet e tij në prapësim nuk qëndrojnë. Tutje ka theksuar se debitori me asnjë prova nuk ka arritur të dëshmojë kundërshtimin e pagesave të faturave, të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet konform nenit 27 dhe 36 të LPP-së, provat e bashkangjitura në prapësim janë jo relevante për këtë çështje dhe nuk dëshmojnë asgjë, përveç që tentohet të zvarritet procedura përmbarrimore. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, të lë në fuqi urdhrin përmbarrimor si dhe ta detyroj debitorin që kreditorit t'ia kompensoj edhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbarrim në shumë prej 104.00 €, si dhe shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim shumën prej 104.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i

pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr.DV-200664464248 të datës 26.06.2020 dhe Faturën Nr.DV-200662204423 të datës 22.06.2020, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula dhe nënshkrimi i debitorit.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarrimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë vulën dhe nënshkrimin e pranimit të debitorit.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarrimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk

lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i' a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 78.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.232/24, datë 30.04.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.